Kronikë

Atentati me 1 viktimë në Milot/ 2 miqtë u ndoqën nga autorët, i pritën 10 minuta në hyrjen e pallatit! Zbrazën 100 plumba në drejtim të tyre

Detaje të reja janë zbardhur nga atentati i një nate më parë në Milot ku mbeti i vrarë Klisman Preci dhe u plagos Ylli Ibrahimi. Burime për Report Tv bëjnë me dije se automjeti i autorëve ka qëndruar për rreth 10 minuta në rrugën përballë rrugicës së pallatit ku jetonin dy personat, të cilët ishin fqinj me njëri-tjetrin.

■ Si po eliminohet grupi i Ervis Martinaj! Nga shoku i ngushtë te kushëriri, Ibrahimi shënjestra e katërt
■ Atentati në Milot/ Makina e blinduar që u qëllua me breshëri kallashnikovi u pa në varrimin e Brilant Martinaj
■ Vrasje mafioze në Milot, 1 i vdekur dhe 1 i plagosur rëndë! U qëlluan sapo zbritën nga makina e blinduar! Të dy i kishin shpëtuar atentateve më parë

Redaksia
23 Korrik, 08:32 | **Përditesimi i fundit: 23 Korrik, 15:18**

Tre persona dyshohet se ishin autorët e atentatit të ***një nate më parë*** në Milot, ku mbeti i vrarë Klisman Preçi, drejtuesi i mjetit tip 'Toyota Land Crusiser' dhe u plagos Ylli Ibrahimi. Burime për Report Tv bëjnë me dije lëvizjet e atentatorëve. Ata kanë qëndruar për rreth 10 minuta në rrugën përballë rrugicës së pallatit ku jetonin dy personat, të cilët ishin fqinj me njëri-tjetrin.

Para ngjarjes, Ylli Ibrahimi dhe Klisman Preçi kishin qenë në një lokal në qendër të Milotit disa metra larg banesave të tyre dhe siç duket atentatorët i kanë ndjekur lëvizjet e tyre.



LEXO EDHE:
Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohen dy finlandezë në Shëngjin

Kur Preçi dhe Ibrahimi mbërritën në rrugën e pallatit, 3 atentatorët e maskuar, 2 në rolin e qitësit, 1 shofer kanë dalë nga makina e tyre tip 'Audi' dhe kanë zbrazur ndaj 2 miqve 3 karikatorë nga dy armë kallashnikov, afërsisht 100 plumba. Duke qenë se mjeti ishte i blinduar, burime bëjnë me dije se njëri prej tyre është afruar tek xhami dhe ka qëlluar në distancë të afërt dhe me pas ata janë larguar me automjetin tip 'Audi'.

Pasi lëshuan breshëri kallashnikovi që nuk po depërtonin mbi makinën e blinduar të Ylli Ibrahimit, autorët i kanë ndjekur deri në hyrje të pallatit ku banon miku i Ervis Martinaj. Në fotot e siguruara nga Report Tv shihet se disa nga plumbat arritën të çajnë blindin dhe kanë depërtuar në xhamin e pasëm.

Pasi u qëlluan me breshëri plumbash, Ibrahimi dhe Preçi u dërguan me urgjence drejt spitalit të Traumës në Tiranë, por 27-vjeçari Preçi nuk mundi të mbijetojë si shkak i plagëve të marra dhe gjeti vdekjen në spital 1 orë pas ngjarjes. Ibrahimi ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore.

Pas ngjarjes u gjet një automjet i djegur në fshatin Gramës të Krujes dhe të cilit dhe dy armë zjarri kallashnikov të cilat dyshohet të jenë përdorur nga atentatorët. Forca të shumta policie të mbështetur dhe nga Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë të Shkodrës mbërritën menjëherë në vendin e ngjarjes, duke bërë krehjen e zonës dhe ngritur pika kontrolli, por pa arritur të bien në gjurmet e atentatoreve.

Me dhjetra persona janë shoqëruar, por deri më tani hetuesit ende nuk kanë asnjë të dyshuar për atentatin. Hetimet e policisë janë pëqëndruar në të shkuarën e Klisman Preçit dhe Ylli Ibrahimit, të dy me precedentë të mëparshëm penal. 46-vjeçari Ylli Brahimi nuk është një emër i panjohur për policinë. Në vitin 2003, ai ishte dënuar për trafik droge, ndërsa i kishte shpëtuar ***një atentati vetëm një vit më parë***. Ndërsa Klisman Preçi, i cili mbeti i vdekur, i shpëtoi një ***atentati në maj të këtij viti***, ku ishte bashkë në makinë me Blerim Preçin.

Vetëm 6 ditë më parë ***një vrasje mafioze*** me tre viktima ndodhi në mbikalimin e Fushë-Krujës, ndërsa nuk dihet nëse atentati i mbremjes së sotme ka lidhje me ngjarjen.

Në përditësim...

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

I plagosuri Ylli Brahimi dhe viktima Klisman Preçi

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:39

Atentati në Milot/ Makina e blinduar që u qëllua me breshëri kallashnikovi u pa në varrimin e Brilant Martinaj

Makina e blinduar 'Toyota Land Crusiser' me të cilën po lëviznin Ylli Ibrahimi dhe Klisman Preçi parë në varrimin e Brilant Martinaj. Ky i fundit u vra në një atentat rreth një javë më parë në mbikalimin e Fushë-Krujës. Së bashku me të ishin edhe Besmir Hoxha e Diklen Vata, të cilët gjithashtu mbetën të vdekur.

Ibrahimi dhe Preçi ishin shënjestër e një atentati mbrëmë në Milot. Ata u qëlluan me breshëri kallashnikovi shumë pranë pallatit të tyre dhe për pasojë Preçi mbeti i vdekur.

Ora 10:33

Atentati në Milot, si po eliminohet grupi i Ervis Martinaj! Nga shoku i ngushtë te kushëriri, Ylli Ibrahimi rasti i katërt që shënjestrohet për t'u vrarë

Atentati me 1 viktimë që ndodhi mbrëmjen e së premtes në Milot dyshohet se ka lidhje me atentatin e Fushë-Krujës ku mbetën të vrarë 3 persona. Njëri prej shënjestrave, **Ylli Ibrahimi** që mbeti i plagosur dhe ndodhet në spitalin e Traumës, mësohet se kishte lidhje me Ervis Martinaj.

Saga e vrasjeve duket sikur nuk ka fund pasi duket se miqtë apo bashkëpunëtorët e Martinajt po bien pre e atentateve nga persona që dyshohet të jenë rivalët e tij. Rasti i fundit ishte i Fushë-Krujës kur u zu në pritë 23-vjeçari **Brilant Martinaj** së bashku me dy shokët Diklen Vata dhe Besmir Hoxha.

Gjithashtu, në gusht të vitit 2019 në Tiranë u ekzekutua ish polici **Santiago Malko**, ndërsa në hetimet e SPAK nënvizohet se plani ishte edhe vrasja e Ervis Martinaj. Për këtë vrasje, u dënua vetëm Bledi Teta me 25 burg. Në kërkim janë Leonard dhe Erlis Duka dhe disa persona te tjerë të cilët kishin rol në këtë organizimin dhe ekzekutimin e Malkos.

Ndërsa në 13 nentor te vitit të kaluar po në Tiranë do ekzekutohej **Erigers Mihasi,** i cili njihej si shok i ngushtë i Ervis Martinajt, ndërsa viktima tjetër Armando Dumani pasagjeri që ndodhej me të në Audin e bardhë, rezulton se është fqinj i tij në Yrshek.

Ora 10:25

Atentati në Milot/ 3 autorët zbrazën 100 plumba ndaj makinës së blinduar të Preçit dhe Brahimit, disa prej tyre depërtuan në xhamin e pasëm

Autorët që kanë organizuar një natë më parë atentatin ndaj Ylli Ibrahimit dhe Klisman Preçit kanë zbrazur 3 karikatorë ndaj dy miqve. Ata i kanë ruajtur lëvizjet e 2 miqve, të cilët kanë pirë kafe në qendër të Milotit dhe më pas kanë shkuar në pallatin ku banonin. Autorët e maskuar kanë qëlluar me rreth 100 plumba drejt tyre, ku Preçi nuk mundi t'i mbijetojë plagëve që mori. Siç shihet nga fotot, disa prej plumabve kanë depërtuar në xhamin e pasëm të makinës.

Shenjat e plumbave

Ora 09:09

Kafja e fundit e Preçit dhe Ibrahimit sëbashku, 3 autorët e maskuar i ndoqën nga qendra e Milotit në pallatin ku jetonin

Detaje të reja janë zbardhur nga atentati mbrëmjen e djeshme në Milot, ku mbeti viktimë Klisman Preçi dhe u plagos Ylli Ibrahimi. Dyshohet se tre kanë qenë atentatorët, të cilët kanë ndjekur lëvizjet e Preçit dhe Ibrahimit, të cilët kanë qenë fillimisht të ulur në kafen e qytetit në Milot dhe më pas autorët i kanë pritur për 10 minuta në hyrjen e pallatit. Mësohet se autorët kanë zbritur nga makina, të cilët kanë qenë të maskuar ma kapuç dhe kanë qëlluar me breshëri ndaj mjetit të blinduar me të cilin lëviznin Preçi dhe Ibrahimi.

Sl.E./LR/Shqiptarja.com

TAG: Ervis Martinaj | atentat | Lezhe | milot | ekzekutohet klisman preci | klisman preci | Ylli Ibrahimi

Komente

Tata: 23/07/2022 14:52

Kur te filloj populli te rrije larg nje te pa puni qe jeton si pasha dhe ta konsideroje anormal lluksin e pa justifikuar,kur te fillojne te kuptojne se nje dite plumbat mbi te do te kapin edhe ty koti,kur hajdutit e kriminelit ti flitet me emrin e vertete dhe jo BISNESMEN,atehere mu d te lindi nje fije shprese per shqiperine,sepse populli ben jeten qe meriton dhe ska ligj qe te detyron te kesh kulture e nder qytetari

Agjenti: 23/07/2022 14:35

Policia vazhdon avazin mbledh gezhoja dhe kreh zona. Merrni dhe nje kreher heres tjeter. Te paafte.

Boba: 23/07/2022 10:24

Ja ku jemi perseri nje jave me vone me nje tjeter atentat. Nje tjeter deshtim i policise qe fokusin kryesor e ka te gjobat rrugore dhe jo te hetimet. O Gledis Nano, do u thuash atyre barinjve te tu qe te zbardhin sikur te pakten nje atentat nga 5 qe behen cdo muaj?

Sot: 23/07/2022 11:52

Po ca deshtimi policie thua. Ku ka polici qe merrem me keto specie. Keta do vriten dhe do vrasin gjithmone, deri sa te shuhen.

Lesha: 23/07/2022 09:01

Ky klismani asht vra kot , ylli ka ken shenjestra . Shum amatora keto vrases . Nuk iket me vrap pa i fut plum kres

lezh: 23/07/2022 16:43

ti flet kollaj byth pal aty duke ngren fara edhe duke komentu ik o barbon

Lleshi: 23/07/2022 14:22

Sa kollaj flet nga kafja ti vlla, Kujton se je ne "playstation" Kto aq injorant sa jane shume po vrasin.. Se mos kujton se jane profesioniste!!! Thjesht i kane ba bet qe do i vrasin dhe i kane hasem Kaq puna, por jo qe kane psikologji dhe intelekt shume, Thjesht guxim momenti nga droga dhe gjujne me Sy mbyll..

Maks: 23/07/2022 08:50

Me lirin e tepert qe quhet anarshi demokratike jeton dhe krimi Ky lloj regjimi eshte i pandar me kriminela

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës:
Në tërësi si e gjykoni presidencën e Ilir Metës në këto 5 vite?

Negative | Pozitive | Nuk e di

Lajme të tjera

Politikë

Akuzat e Rithemelimit: 4 të vrarë në 2 atentate nën hundën e policisë! Shqipëria në gjendjen e emergjencës së rendit dhe sigurisë

23 Korrik, 13:17

Kronikë

Vrasje mafioze në Milot, 1 i vdekur dhe 1 i plagosur rëndë! U qëlluan sapo zbritën nga makina e blinduar! Të dy i kishin shpëtuar atentateve më parë

22 Korrik, 21:16

Kronikë

Makina luksoze shkrumbohet plotësisht në Lezhë, shpëtojnë dy të rinjtë, dyshohet se mori flakë në lëvizje (FOTO)

22 Korrik, 20:55

Sociale

Vëzhgimi i Report Tv/ Çadrat bosh në Shëngjin e gjirin e Lalzit, pushuesit: Çmimet janë shtrenjtuar, nuk përballojmë dot pushime më shumë se një javë

Artur Korriku

Elvis Hila

22 Korrik, 17:26

Kronikë

Shëngjini pa energji elektrike që prej orës 2 të mëngjesit, dëmtohen fidrat nga zjarri pranë Knallës (VIDEO)

Elvis Hila

22 Korrik, 08:50

Kronikë

Zjarr në Krastë të Elbasanit, përfshihet nga flakët një sipërfaqe me ullinj në Peqin, përsëri riaktivizohet vatra në Brezane të Lezhës

21 Korrik, 21:04

Kronikë



3 të vrarë në Fushë-Krujë, në makinën e viktimave u gjet një pistoletë! Lidhja me ekzekutimin e ish policit Reçi, mbesa e tij e fejuar me armikun e Martinajve

Sokol Dema

21 Korrik, 14:52

Kronikë

Pas ndërhyrjes nga ajri, shuhet zjarri pranë Urës së Zogut në Lezhë! Izolohen plotësisht flakët në Balldre dhe Orosh

20 Korrik, 09:43

Sociale

Dy aksidente me gomone, Report Tv vëzhgim në Jalë, Radhimë, Shëngjin, Velipojë, asnjë kontroll në plazhe! Pushuesit: Kemi frikë, lëvizin me shpejtësi

19 Korrik, 16:09

Kronikë

VIDEO/ Situatë problematike nga zjarri në Lezhë, plasin municionet luftarake! Rrezikohen banesat! E pamundur ndërhyrja e zjarrfikësve

19 Korrik, 07:11

Sociale

Në kulmin e sezonit, zonat e Shëngjinit pa ujë të pijshëm! Banorët: Uji vjen 1 herë në javë dhe është i pakonsumueshëm

Elvis Hila

18 Korrik, 20:28

Opinion

Frrok Çupi: E kishim këtu vrasjen me pagesë, veçse e paguante shteti

Frrok Çupi

18 Korrik, 16:36

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje